

VENDIM
Nr. 394, datë 3.5.2017

PËR DiSA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 544, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “*GREEN COAST*”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 544, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1 Bashkia Himarë ka detyrimin që brenda 15 ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “*Green Coast*”, të lidhin kontratën përkatëse për lejin e përdorimit të brigjeve të detit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar nga vendimi i KIS-it.

2.2 Së bashku me kërkesën, investitori strategjik “*Green Coast*” duhet të paraqesë pranë Bashkisë Himarë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ekstrakt të 3 muajve të fundit nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Planvendosje të sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;
- Përshkrim të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.”.

2. Pika 3 riformulohet, si më poshtë vijon:

“3. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, 15 maj - 30 shtator të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Himarë. Kjo tarifë do të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 2.1 dhe 2.2, më sipër, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.”.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi